

community

The New Apostolic Church around the world

03/2017/AI

Festimi i Darkës së Shenjtë

100 vjet Ostie – në lëvizje

Shërbesë fetare në
N'Djamena: Ne i qëndrojmë
besnik premtimit tonë

Editoriali: Lavdërim dhe
falenderim

Mësime nga kisha: Përlulja

New Apostolic Church
International



Lavdërim dhe falenderim

Të dashur motra e vëllezër të besimit,

motoja e vitit „Qoftë lëvduar Perëndia, Ati ynë“ përmban brënda vetes tre detyra, që ne për vitin 2017 i kemi marrë përsipër. Kur jemi ndërgjegjësuar për madhësitinë e Perëndisë dhe të krijimit të tij – që është detyra e parë – ne dëshirojmë ta lavdërojmë dhe ta falenderojmë Perëndinë. Të mbetesh me njohuritë e fituara pa lëvizur, jo aktiv dhe i heshtur do të ishte një reagim i gabuar.

Lavdërim dhe falenderim – si realizohet kjo konkretisht në jetën e përditshme?

Ne e falenderojmë Perëndinë me gatitshmërinë tonë për të sakrifikuar. Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për para. Bëhet fjalë për mirënjohje ndaj Perëndisë. Ne i jemi mirënjohës Perëndisë dhe i japim atij diçka prej asaj, që kemi marrë prej tij.

Ne e falenderojmë Perëndinë me gatitshmërinë tonë për pajtim. Meqë i jemi mirënjohës Perëndisë për mëshirën dhe faljen e tij, ne jemi të gatshëm ta falim fqinjin tonë.

Ne e falenderojmë Perëndinë me shërbimin tonë. Ne nuk i shërbejmë Perëndisë për arsye se kërkojmë të fitojmë ose të marrim diçka. Ne i shërbejmë atij sepse kemi marrë tashmë gjithshka, sepse ai na ka premtuar trashëgiminë e tij.



Foto: NAC International

Pasi e kemi dalluar madhësitinë e Perëndisë dhe të krijimit, ne dëshirojmë ta nderojmë Perëndinë dhe ta falenderojmë atë për mëshirën, për përkushtimin e tij. Ne e falenderojmë atë me anë të gatishmërisë sonë për të sakrifikuar, për t'u pajtuar dhe duke i shërbyer atij dhe fqinjit tonë.

Përshëndetje të përzemërta, i juaji

Jean-Luc Schneider

1000 besimtarë u bashkuan të shtunën më 22 janar 2017 me apostulin kryesor Jean-Luc Schneider për shërbesë fetare në N'Djamena (Tschad).



Foto: NAC Canada

Danieli 3,17.18

„Ja, Perëndia ynë, të cilit i shërbejmë, është në gjëndje të na çlirojë nga furra e ndezur, dhe do të na çlirojë nga dora jote, o mbret. Por edhe sikur të mos e bënte, dije, o mbret, që ne nuk do t’u shërbejmë perëndive të tua dhe nuk do të adhurojmë figurën e artë që ti ke ngritur.”

Ne i qëndrojmë besnik premtimit tonë

Shumë të dashur motra e vëllezër këtu në Christo, të dashur të ftuar, gëzoj që mund të ndajë bashkë me ju këtë shërbesë fetare dhe që kam mundësi të marrë bashkë me ju bekimin e Perëndisë sonë.

Sot në mëngjes dëgjuam një fjalë; është fjala për historinë e Danielit dhe shokëve të tij. Jam shumë i sigurt se të gjithë ju këtu në N’Djamena e njihni këtë histori.

Nebukadnezari, mbreti i Babilonisë, pushtoi Izraelin dhe Judenë dhe mori me zor të burgosur për në Babiloni. Ndër ta ishte Danieli, Shadraku, Meshaku dhe Abednebo. Ai iu bëri një propozim: „Ju propozoj që gjatë këtyre tre viteve të studioni në oborrin tim.“ Në botën antike, Babilonia ishte ndoshta qytetërimi më i avancuar. Pastaj mbreti shtoi: „Në fund ju do të merrni pastaj në mbretërinë time poste me

rëndësi.“

Ky ishte një shanc i pabesueshëm për këta tre djem të varfër të zënë rob; Megjithatë kushti ishte si vijon: „Ju do të hani prej ushqimit të mbretit dhe do të pini prej pijeve të tija.“ Të rinjtë kishin një interes të madh ndaj këtij propozimi, megjithatë ata thanë: „Ne nuk mund të hamë prej ushqimeve të mbretit, kjo shkon kundër besimit tonë.“ Aty ata bënë këtë kompromis: „Na lejoni që të hamë ushqimin tonë dhe ne do t'i ndjekim pas mësimet tuaja. Perëndia do të na bëjë që të kemi sukses në këtë.“ Dhe po kështu vepruan. Ata i qëndruan besnik Perëndisë, vazhduan të ishin të bindur ndaj ligjit dhe studiuan. Pas kësaj, ata jo vetëm që morën poste të larta në mbretëri, por u bënë edhe një burim bekimi si për mbretin ashtu edhe për të gjithë vendin, kaq mirë i shërbenin atij.

Më vonë mbreti urdhëroi të ndërtohej një statujë dhe vendosi: „Tani e tutje nuk do të adhurohet më asnjë perëndi tjetër. Gjithkush duhet të adhurojë këtë statujë dhe ai që nuk e bën, do të gjejë vdekjen.“ Aty të rinjve tanë, iu bë e qartë se nuk mund të bënin dot më asnjë kompromis: ose do ta mohonin Perëndinë e tyre dhe të jetonin, ose t'i qëndronin besnik dhe të vdisnin. Nuk kishte asnjë rrugë tjetër.

Ata i qëndruan besnik Perëndisë dhe i thanë mbretit: „Në qoftë se Perëndia ynë do, ai mund të na shpëtojë. Ai mund të na shpëtojë prej vdekjes, por për ta mohuar, ne nuk do ta bëjmë kurrë.“ Ju e njihni historinë. Mbreti lejoi t'i hidhnin në furrën e zjarrtë dhe kur hodhi një vështrim brënda, pa se nuk ishin më tre por katër veta. Engjëlli i Perëndisë ishte në furrë bashkë me ta për t'i mbrojtur. Mbreti lejoi që t'i nxirrnin përsëri dhe ata u bënë akoma edhe më të rëndësishëm në mbretëri, me të vërtetë për të gjithë një burim i madh bekimi.

Të dashur motra e vëllezër, kjo histori e vjetër ka për të na thënë shumë në lidhje me jetën tonë të besimit. Këta njerëz të rinj ishin pjesë e popullit të zgjedhur, e popullit të Perëndisë. Ne jemi të zgjedhurit e Perëndisë, jemi ata, që Perëndia i ka zgjedhur për të qenë fëmijët e tij. Kur ne u pagëzuam dhe u bëmë kështu të krishterë, premtuam t'i bëjmë ballë mëkatit dhe të ndjekim pas Jezu Krishtin. Kur ne morëm nga një apostul Vulën e shenjtë dhe dhuntinë e Shpirtit të shenjtë, morëm angazhimin për t'u përgatitur për Rikthimin e Krishtit. Këto janë dy premtime, dy angazhime që ne i morëm përsipër. Ne dëshirojmë t'i bëjmë ballë mëkatit dhe të ndjekim pas Jezusin dhe duam

të përgatitemi prej apostujve për ardhjen e dytë të Jezusit.

Megjithatë ne ende jetojmë në tokë dhe na duhet të punojmë, të shtojmë jetën tonë, të sigurojmë ushqim, veshje dhe strehim. Ne duhet të kujdesemi për fëmijët tanë, të sigurojmë të ardhmen e tyre. Me të vërtetë jemi të krishterë dhe fëmijë Perëndie, por kërkojmë të kemi edhe një jetë të suksesshme. Ne, nuk është se jemi të dënur të mbetemi të varfër, vetëm sepse jemi apostolik të rinj. Nuk është se e kemi të ndaluar të kemi sukses në jetë vetëm sepse jemi fëmijë Perëndie. Është mëse normale të duash të jesh i suksesshëm dhe i lumtur. Është normale që përpiqemi për një sukses të caktuar shoqëror.

Shembulli i të rinjve na tregon se si duhet të veprojmë. Prioriteti ynë kryesor është Mbretëria e Perëndisë. Ne kemi premtuar se do t'ju përmbahemi dhjetë urdhëresave dhe do të përgatitemi për Ditën e Zotit. Nëse përpiqemi për sukses, mirëqënie dhe lumturi, atëherë këtë e bëjmë duke iu përmbajtur urdhërimeve të Perëndisë dhe duke i dhënë shpirtit tonë

përparësi. Kjo është detyra jonë. Po, neve kërkojmë të kemi sukses në jetën në tokë, por duke iu përmbajtur urdhërimeve të Perëndisë dhe duke i dhënë prioritet, përparësi shpirtit tonë; shembulli i të rinjve në furrën e zjarrtë na tregon se kjo gjë është e mundur, veçse duhet vepruar si ata.

Njeriu duhet t'u bindet urdhëresave, të jetë besnik dhe së dyti edhe të punojë. Ne nuk mund t'i themi Perëndisë së dashur: „Dëgjo pak, unë i respektoj urdhërimet, përpiqem të mos mëkatoj, unë shkoj në kishë dhe kujdesem për shpirtin tim. Më jep paratë për të cilat kam nevojë.“

Ne duhet t'i bëjmë të dyja: të mbajmë premtimin që i kemi dhënë Perëndisë dhe të punojmë si të gjithë të tjerët. Kur i bëjmë që të dyja, punën, investimin për ne dhe për fëmijët tanë, kur mbajmë urdhëresat dhe i japim përparësi shpirtit tonë, atëherë Perëndia do të na bekojë.

Po si vjen bekimi i tij? Ngandonjëherë Perëndia flet për sukses dhe ne kemi sukses në jetë, kemi të ardhura, jemi të shëndetshëm, kemi një punë: bekimi i tij qëndron në faktin që ne nuk kemi vetëm sukses, por edhe vetë Jezu Krishtin, ne kemi marrë Jezu Krishtin! Kemi paqe në zemër. Kemi shpëtimin. Ky po që është një bekim!

Ndonjëherë, bekimi shprehet edhe në një mënyrë tjetër: ne nuk marrim të gjitha ato që do të donim të kishim. Nuk

Përparësia jonë kryesore është Mbretëria e Perëndisë.

kemi sukses në të gjitha punët që ndërmarim, edhe pse kemi qenë të bindur ndaj Perëndisë dhe iu jemi përmbajtur urdhërimeve. E përsëri ndërgjegjësohesh se: bekimi i Perëndisë është aty! Pavarësisht kësaj ai na ka bekuar! Edhe pse të gjitha dëshirat nuk janë realizuar, përsëri ne kemi paqe në zemër. Ne nuk ndjejmë se na duhet të akuzojmë të tjerët, as nuk jemi të hidhëruar dhe agresiv. Edhe pse dëshirat nuk janë realizuar, ne kemi paqe në zemër dhe jemi të lumtur në Jezu Krisht.

Ky është bekimi që Perëndia ia jep atij, që është i bindur ndaj tij dhe bën punën që ai kërkon. Ai na jep sukses sipas vullnetit të tij dhe mbi të gjitha paqe në zemër. Ne nuk ia shitëm shpirtin tonë djallit e përsëri ndonjëherë Perëndia na thotë: „Jo, nuk po të të jap sukses, por gjithsesi do të të bekoj.“ Dhe edhe pse nuk i kemi të gjitha ato që dëshirojmë, kemi paqen në zemër, jemi të lumtur në Jezu Krisht dhe jemi bekim për të tjerët.

Të dashur motra e vëllezër, ai që i mban urdhërimet e Perëndisë nuk e lëndon kurrë të afërmin e tij.

Fatkeqësisht sot janë të shumtë ata që kërkojnë të kenë sukses absolut. Ata kërkojnë të jenë të pasur, të famshëm dhe të lumtur; për ta arritur këtë, ata nuk ndalen para asgjëje. Ai, i cili kërkon të ketë sukses duke e ndjekur pas ligjin e Krishtit dhe të Perëndisë, është një bekim për të gjithë, sepse nuk e ndërton asnjëherë lumturinë e tij mbi fatkeqësinë e të tjerëve. Ai është një bekim pasi është një dëshmitar i mirfilltë, i vërtetë i Krishtit dhe dëshmon: atë çfarë Jezusi kërkon mund të bëhet, ajo është e mundur. Këtë mund ta mësojmë prej pjesës së parë të historisë (burrat në furrën zjarrtë).

Por tani vjen pjesa e dytë e kësaj historie, e pikërisht çështja me statujën dhe furrën e zjarrtë. Edhe ne ndodhemi ndonjëherë brënda situatave, në të cilat nuk mund të bësh asnjë kompromis. Ne na duhet të marrim një vendim, të bëjmë një zgjedhje: ose të jemi me Perëndinë ose kundra tij. Jemi në një situatë, ku na duhet ta mohojmë Perëndinë, që të marrim diçka dhe këtu nuk është i mundur asnjë kompromis. Aty vlen të zgjedhësh dhe të zgjedhësh mirë madje.

Ndonjëherë kemi të bëjmë me kundërshtarë, që Testamenti i Ri i quan „kundërshtarë të Krishtit“; ne përballemi me njerëz, të cilët na lëndojnë dhe na trajtojnë keq vetëm sepse jemi të krishterë, sepse jemi fëmijë Perëndie dhe apostolik të rinj.

Në disa vende të kësaj bote, të krishterët përndiqen për



Apostuli kryesor Jean-Luc Schneider emëron apostujt Ndangalngar Nao (djathtas) dhe Jean Blague Koioyoutan (në mes)

shkak të besimit të tyre; Atyre u jepet zgjedhja: „ose do ta mohosh Krishtin ose do të të vrasim!“ Shumë të krishterë e kanë guximin të thonë pastaj: „Më mirë vdes, se sa ta mohoj Krishtin!“ Kjo nuk ka ekzistuar vetëm në kohën e kishave të para të krishtera, për fat të keq kjo ndodh edhe sot në këtë botë dhe ne lutemi për këta të krishterë, që Perëndia të mund t'i ndihmojë ata. Këtu në N'Djamena nuk është se jemi në një situatë të tillë, megjithatë ekzistojnë njerëz, të cilët na bënë të liga vetëm sepse duam t'u përmbahemi urdhërimeve të Perëndisë, të cilët na përqeshin vetëm sepse jemi apostolik të rinj, na trajtojnë keq vetëm prej besimit që kemi.

Të dashur motra e vëllezër, ne dëshirojmë t'i bëjmë ballë kësaj. E di, ndonjëherë është më e thjeshtë të thuash: „atëherë po shkoj më mirë në një kishë tjetër dhe po bëhem pjesë e një besimi tjetër, që të mos më bezdisin më.“ Por jo, le t'i qëndrojmë besnik Jezu Krishtit, le t'i qëndrojmë besnik premtimit tonë solemn të pagëzimit, premtimi solemn të Vulës së shenjtë, le të preferojmë më mirë të vuajmë pak, sesa të heqim dorë prej besimit tonë.

Të dashur motra e vëllezër, ata që veprojnë kështu do të



përjetojnë atë që përjetoj edhe Stefani: edhe ai duhet të vuante vetëm sepse i qëndroi besnik Jezu Krishtit, por në vuajtjen e tij ai pa Jezu Krishtin që e shikonte prej qiellit dhe ishte bashkë me të. Ata që vuajnë për shkak të vullnetit të Jezu Krishtit do të përjetojnë përherë e gjithmonë se ai është bashkë me ta, i ndihmon dhe i ngushëllon ata. Të rinjtë i thanë mbretit: „Ti mund të bësh çfarë të duash, Perëndia ynë është më i fuqishëm. Ai mund të na shpëtojë prej vdekjes.“ Ne i themi djallit: „Ti me të vërtetë që mund të na lëndosh sot, por Jezusi është më i fuqishëm se ti. Në fund të kësaj historie është ai që do të korrë fitoren. Ai do të na shpëtojë prej të ligut dhe do të na japë jetën e përjetshme; dhe pasi kemi këtë premtim, ne nuk pranojmë ta mohojmë Jezusin dhe besimin tonë. Më mirë preferojmë të vuajmë pak për hir të tij, në mënyrë që më vonë të mund të jemi bashkë me të përjetësisht.“

Një tjetër rast: Ndonjëherë na duhet të heqim dorë nga një dëshirë apo pasion, pasi nuk është në përputhje me besimin tonë. Ne aspirojmë pasuri ose një status social të caktuar, dëshirojmë të marrim këtë apo atë post, ose ndonjë rol të caktuar, të kemi diçka tonën, por ndërgjegjësohemi se për këtë na duhet të mos jemi të bindur kundrejt Perëndisë.

Për të marrë atë që duam, do të duheshe të gënjenim, të vidhnim ose të korruptoheshim. Atëherë aty ne themi: „Jo, këtu më mirë i qëndroj besnik Perëndisë e i bindem atij dhe heq dorë prej asaj që do të doja të kisha.“

Të dashur motra e vëllezër, ekzistojnë situata në të cilat nuk mund të bësh asnjë kompromis. Nëse do të na duheshe ta mohonim Perëndinë ose të shkelnim dhjetë urdhëresat, me qëllim që të merrnim diçka, të mbanim ndonjë post apo të bëheshim pjesë e ndonjë rrethi të caktuar, atëherë ne themi: „Jo, unë nuk dua ta mohoj Perëndinë tim, më mirë heq dorë prej ambicies dhe dëshirës sime, se sa ta tradhëtoj atë. Për ne Jezu Krishti është më i rëndësishëm sesa pasuritë dhe kënaqësitë e kësaj toke.“ Këtu duhet të qëndrojmë të palëkundur.

Nuk bëhet fjalë vetëm për të mbajtur urdhëresat e Perëndisë. Ne jemi zotuar të përgatitemi edhe për Rikthimin e Zotit: për këtë na duhet shërbesa fetare, fjala e Perëndisë, Darka e Shenjtë, na duhet ndjekja pas e apostujve. Edhe këtu ndonjëherë duhet të vendosim: ose këtë ose atë. Por, tek të gjitha vendimet tona ne e dimë shumë mirë se: „nëse zgjedh të eci në këtë rrugë, nuk do të mund të vi më në



shërbesë fetare.“

Një shembull konkret? „Nëse marthohem me këtë burrë, do të më duheshe të bëhem pjesë e besimit të tij. Nuk do të mund të shkoj më në kishën time, porse në kishën e tij; nuk do të mund të përgatitem për rikthimin e Zotit, s'do të kem më apostujt apo Darkën e shenjtë.“

I dashur „babi“ im, çfarë zgjedhje do të bësh për vajzën tënde? Dhe ky është vetëm një shembull.

A të kujtohet se si e ke çuar vajzën tënde për të marrë Vulën e shenjtë? Aty ti u zotove: „Do të bëj çfarë është e mundur, me qëllim që ajo të mund të jetë aty Ditën e Zotit.“ Dhe ti e di shumë mirë se, nëse ajo marthohet tani me këtë burrë, do t'i duheshe të shkonte në kishën e tij. Cilin vendim do të marrësh? Ky është vetëm një shembull meqë jemi këtu në „Shtëpinë e gruas“. Dhe është mirë kështu.

Të dashur motra e vëllezër, ndonjëherë kemi nevojë

për shembuj konkret, që të kuptojmë siç duhet atë çfarë kërkojmë të themi. E them shumë seriozisht. Kur gjendemi përpara një zgjedhjeje të tillë, kërkojmë të marrim vendimin e duhur. Ne i mbetemi besnik zotimit të pagëzimit dhe të Vulës dhe preferojmë më mirë të heqim dorë nga disa gjëra sesa ta mohojmë Jezu Krishtin.

Zoti kërkon prej nesh që ta falim të afërmin tonë.

Një ditë Zoti i tha një njeriu: „Eja dhe më ndiq pas!“ Ai iu përgjigj: „Po, do të vij, por në fillim më duhet ta varros babanë tim.“ Atëherë Jezusi i tha: „Lëri të vdekurit të varrosin të vdekurit e tyre dhe më ndiq menjëherë pas!“ Për një hebre ishte e paimagjinueshme të

mos e varrosësh të atin, dhe ai që nuk e bënte përjashtojë menjëherë nga shoqëria. Me këtë Jezusi donte të tregonte se ndjekja pas është më e rëndësishme sesa rregullat e shoqërisë.

Të dashur motra e vëllezër, ne të gjithë i përkasim një shoqërie, një kulture, një populli, një tradite të caktuar dhe është mirë që është kështu. Por nëse tradita e familjes,

e kulturës apo shoqëria na pengon për ta ndjekur pas Krishtin, atëherë ne duhet të themi: „Këtu merr fund!“ Edhe nëse pastaj mjedisi ynë ushtron presion mbi ne dhe na thotë: „Por të gjithë veprojnë kështu, ky është rregulli tek ne“, ne iu përgjigjemi: „Këtë nuk po e quajmë të pavlefshme, por ju lutem na kuptoni: Thirrja e Jezusit është më e rëndësishme se të gjitha traditat!“

Po citoj dhe një rast të tretë, në të cilin nuk është i mundur asnjë kompromis për të ndjekur pas Krishtin. Ne duhet të heqim dorë prej Adamit të vjetër, prej krijesës së vjetër. Ai, që është pagëzuar me Ujë dhe Shpirt duhet ta lërë të vdesë njeriun e lashtë (Adamin), në mënyrë që të bëhet një njeri i ri në Krisht. Këtë e tregoi Jezusi, këtë e tregoi edhe apostul Pali: për të mund t'u rritur në Jezus, duhet tjetri të dobësohet.

Ne heqim dorë prej të gjitha gjërave, që nuk i pëlqejnë Perëndisë në karakterin dhe personalitetin tonë. Ne të gjithë kemi personalitetet, mendimet dhe idetë tona, por ka edhe të tilla, me të cilat Jezusi nuk është dakort. Unë mund të kem një mendim për të afërmin tim, e të them: „Unë e di që ai është i keq, që është kështu e ashtu; e kam përjetuar vetë.“ Dhe Jezusi na thotë: „Po, por unë e shoh atë krejt ndryshe. Unë e dua atë dhe dëshiroj që ai të jetë i shpëtuar, njësoj si ti.“ Dhe nëse krijohet një konflikt i (brëndshëm), kush ka pastaj të drejtë? Jezusi apo unë? Aty, mund të them shumë mirë: „Unë e di se ky njeri është i keq“, por pastaj nuk pajtohemi më me Krishtin. Aty duhet të vendos: ose do t'i mbetesh besnik mendimit tënd dhe nuk pajtohesh me Jezusin, ose do të heqësh dorë prej tij dhe ke paqen me Jezusin. Si do të vendosësh?

Zoti pret prej ne që ne ta falim fqinjën tonë. Nëse atëherë themi: „Po e fala, ai do ta ketë të lehtë. Këtu unë humbas ambicien time; nëse unë e fal atë quhem i dobët, përulëm.“ Të gjithë do të të shohin si një të pafuqishëm sepse i hape rrugë, po në fakt përse fal ti? Pikërisht pasi e dimë se e kemi të domosdoshme faljen e mëkateve tona dhe për këtë ne na duhet edhe të falim! Për ne paqja në Jezus dhe mëshira janë shumë herë më të rëndësishme sesa ambicia dhe etja për hakmarrje. Kështu ne heqim dorë prej ambicies dhe konceptit tonë të drejtësisë, në mënyrë që të vazhdojmë sipas rrugës së Jezusit dhe të falim.

Ne heqim dorë gjithashtu nga gjithshka që e dëmton unitetin. Të shumtë janë ata që na thonë: „Ajo që unë bëj është e mirë, unë kam të drejtë“, dhe kjo ndoshta mund të jetë e vërtetë: ata kanë të drejtë. Me anë të sjelljes së tyre ama ata e prishin unitetin e fëmijëve të Perëndisë. Dëshiron pra të kesh të drejtë, apo të mbrosh unitetin? Për atë, që kërkon

ta ndjekë pas Jezu Krishtin dhe të përgatitet për rikthimin e tij, uniteti i popullit të Perëndisë është më i rëndësishëm sesa të pasurit të drejtë. Për hir të Jezusit, ai e ka më mirë gabim dhe e mbron unitetin e Krishtit.

Këtë, të dashur motra e vëllezër na mëson kjo histori. Ne jemi përzgjedhur prej Perëndisë, ne i jemi zotuar për besnikëri atij, kemi premtuar t'ju përmbahemi urdhëresave dhe të përgatitemi për rikthimin e Krishtit. Kjo nuk na ndalon për të pasur sukses në jetë. Ne na duhet të punojmë. Ai që është i bindur dhe punon, bekohet prej Perëndisë. Perëndia i jep atij sukses dhe paqe. Edhe vetë kur ky nuk ka sukses, ka paqe dhe gëzim në zemër, paqe në Jezu Krisht. Ai është një bekim për mjedisin që e rrethon, pasi nuk lëndon askënd në përpjekjen e tij për sukses.

Por, në disa raste na duhet të marrim një vendim, meqë asnjë kompromis nuk bëhet dot. Atëherë ne preferojmë më mirë të vuajmë për hir të Krishtit, sesa ta mohojmë atë. Ne heqim dorë prej të gjitha gjërave që mund ta pengonin ndjekjen pas të Krishtit dhe arritjen e qëllimit; dhe e lëmë të vdesë Adamin e vjetër me qëllim që të bëhemi një krijesë e re në Krisht. Perëndia na e garanton bekimin e tij në këtë. Të rinjtë u shpëtuan prej vdekjes dhe morën një pozitë më të lartë se më parë. Jezusi do të na japë shpëtimin, ai do të na ringjallë dhe ne, do të jemi tek ai si mbretër e priftërinj në Mbretërinë e tij. Kështu që nuk ka më hezitim: ne qëndrojmë në anën e Jezu Krishtit. Amin.

MENDIME KYÇE

Perëndia bekon punën e atyre që i binden atij duke iu dhënë paqe. Ai u dhuron shpëtim atyre, që heqin dorë prej mëkatit dhe e ndjekin pas Zotin pa kompromis.

Mbas gjurmëve të të Birit



Foto: Michael Voigt

Këto rreshta i referohen bërjes njeri të Birit të Perëndisë: „Jezu Krishti ishte Perëndi e vërtetë dhe njeri i vërtetë“, shpjegon drejtuesi i kishës.

Perëndi e vërtetë ...

„Ai ishte shëmbëlltyra e Perëndisë së padukshme. Perëndia erdhi në tokë si Biri, dhe nëpërmjet tij dhe në të, dallonte njeriu Perëndinë e vërtetë, ashtu siç ai me të vërtetë ishte dhe me të vërtetë është.“

- Perëndia është e vërteta: „Biri i Perëndisë ishte tashmë. Perëndia e kish premtuar dhe kjo u bë realitet.“
- Perëndia është dashuria – jo një dashuri teorike, porse një që vepron fuqishëm: „Ai shkoi deri në fund, deri nën kryq.“
- Perëndia është afër: „Ai e ka ndarë fatin me njerëzit – si dhimbjen edhe vdekjen.“
- Perëndia është mëshirë: „Jo një Përëndi, që dëshiron të hakmerret dhe të dënojë njerëzit.“
- Perëndia është i gjithëfuqishmi: „Askush nuk mundi ta ndalë atë. Ai ishte më i fortë sesa vdekja.“

... dhe njeri i vërtetë

„Jezusi ishte njeri i vërtetë si gjithë të tjerët, i njëjtë me të gjithë e megjithatë, Ai ishte Biri i Perëndisë“, tha apostuli kryesor: „Si duhet kuptuar kjo?“

- Jezusi është Adami i ri: „Njeriu, që ka marëdhënien e duhur me Perëndinë.“
- Jezusi është i parëlinduri ndër shumë vëllezër: „Atyre që besojnë në Jezus, ai u ka dhënë forcë për t’u bërë fëmijë Perëndie.“
- „Si fëmijë Perëndie ne duhet të bëhemi shëmbëlltyra e tij.“ Konkretisht kjo nënkupton: Të jemi ashtu siç ishte Jezu Krishti dhe të kemi po atë lidhje me Perëndinë që kishte ai.

Ngjashmëria si shembull

„Çfarë ishte e veçantë tek Biri i Perëndisë kur ishte në tokë?“, ngrihet pyetja në kërkim të një filli drejtues. Dhe: „Çfarë duhet të na karakterizojë ne?“

- Një vetëdije e qartë ndaj birësisë hyjnore të tij: „Si fëmijë Perëndie që jemi, ne e dimë se: Jemi rrugës për tek Ati. Kjo vetëdije duhet të jetë e gjallë brënda nesh, çdo ditë, në çdo situatë të jetës sonë, pasi e dimë se asgjë nuk qëndron përgjithmonë, është vetëm një etapë, ne jemi rrugës drejt Atit.“
 - Lidhja e ngushtë me Atin Qiellor: „Ne duhet ta dëgjojmë atë, duhet të flasim me të, pasi kërkojmë ta njohim më mirë atë.“ Për këtë duhet fjala nga Shpirti i Shenjtë dhe një jetë e gjallë në lutje.
 - Besimi i pakufishëm ndaj Atit: „Nuk po kuptoj absolutisht asgjë, kam arritur në fund, nuk mundem më, boll më, por o At, unë kam besim tek ti. Unë po lë gjithshka, gjithshka në dorën tënde.“
 - Të qënurit të bindur ndaj Atit: „Ne kemi imagjinatën tonë, dëshirat tona, kjo është e natyrshme. – Ne jemi të ndërgjegjshëm ndaj ofertave të shumta të kësaj bote dhe ne i shfrytëzojmë ato. Por ekziston një kufi: Ky është vullneti i Perëndisë.“
 - Shërbimi ndaj njerëzve: „Ne vihemi në shërbim të njerëzve, të cilët na rretojnë që t’i shërbejmë Perëndisë. – Shpëtimi, çlirimi është çështje e Zotit, ndërsa ne jemi në shërbim, me qëllim që njerëzit të arrijnë ta dallojnë ofertën e mëshirës.“
- „Këtë nuk e them unë, e thotë vetë Pali“, përfundon kështu apostuli kryesor: „Perëndia dërgoi Birin e tij. Ai ishte njeri mbi këtë tokë, por edhe biri i Perëndisë. Ne duhet t’i ngjasojmë shëmbëlltyrës së tij, sepse jemi fëmijë të Perëndisë. Unë besoj se kjo është një detyrë e mrekullueshme.“

MESIA DHE MBRETERIA E TIJ E PAQES

(ISAIA 11)

Pothuajse më shumë se 700 vjet para lindjes së Jezusit, në Jeruzalem jetonte një profet. Ai quhet Isaia. Nëpërmjet tij, Perëndia bën të njohur ardhjen e Mesisë. Isaia përshkruan gjithashtu se si do jetë, kur ky Mbret i paqes do ta rindërtojë Mbretërinë e tij:

Një filiz do të dalë nga trungu i Isait (babait të Davidit) dhe një degë do të çelë fryt prej rrënjëve të tij.

Shpirti i Perëndisë do të shplodhet mbi të: Shpirti i mënçurisë dhe i dijes, shpirti i këshillës dhe i forcës, shpirti

i njohjes dhe i ndrojtjes ndaj Zotit.

Dhe ai do të gjej kënaqësi në ndrojtjen ndaj Zotit. Ai nuk do të gjykojë sipas asaj që i shohin sytë, dhe as nuk do të dënojë sipas asaj që i dëgjojnë veshët. Por ai do t'i gjykojë me drejtësi të varfërit dhe do t'u japë të drejtë të gjorëve të vendit. Me shkopin e gjuhës së tij ai do të rrahë keqbërësit dhe me frymën e buzëve të tija do të vrasë njeriun e pabesë.

Drejtësia do të jetë rripi i ijëve të tija dhe besnikëria rripi këllqeve të tija.

Ujqërit do të rrijnë bashkë me qengjat dhe panterat do të strehohen tek dhitë.

Një djalë i vogël do t'i mbrojë si viçat e vegjël e ata më të rriturit, bashkë me luanët e vegjël.

Lopët dhe arinjtë do të kullosin së bashku dhe këlushët e tyre do të qëndrojnë pranë njëri tjetrit.

Luanët do të hanë kashtë ashtu si viçat. Një foshnje do të luaj aty ku kastori ka vendin e tij të fshehjes dhe një fëmijë i vogël do ta fusë dorën në strofkullën e gjarpërit.

Askush nuk do të bëjë të këqija. Nuk ekzistojnë më mëkate mbi Malin e Shenjtë të Perëndisë. Vendi do të jetë plot me njohuritë e Perëndisë, po ashtu sa është deti plot me ujë. Në atë kohë do të ndodhë, që filizi nga rrënjët e Isaisë do të qëndrojë aty si një shenjë për popujt. Popujt do të pyesin për të dhe vendet, në të cilat ai banon do të jenë madhështore.

Një njeri quhet në Bibël profet, kur ky është zgjedhur nga Perëndia për të shpallur vullnetin e tij. Profetët e këshillojnë popullin e Izraelit dhe e paralajmërojnë atë para shkatërrimit. Kjo sepse, Izraelitët dhe sunduesit e tyre nuk e përfillin vullnetin e Perëndisë dhe adhurojnë idhujt. Shumtë profetë flasin për të ardhmen. Sidomos profeti Isaia tregon vazhdimisht për Jezu Krishtin dhe për Ditën e Zotit. Isaia përshkruan lindjen, veprën dhe vuajtjen e Birit të Perëndisë.

Dhe se si do të jetë në Mbretërinë e paqes së Zotit.



PER VIZITE TEK SUHANI NGA RAIPURI (INDI)



Këtu mund të më shihni – mua më pëlqejnë lulet!

Emri im është Suhani, unë jam dhjetë vjeç. Unë jetoj në Raipur, ky është kryeqyteti i landit Chhattisgarh në Indi. Raipuri është një qytet, në të cilin ecja me biçikletë është shumë e parapëlqyer. Edhe mua më pëlqen shumë të eci me biçikletë; pa shikojeni biçikletën time.

Babai im quhet Daniyal, ai zotëron një dyqan mode. Mua më pëlqen të vishem bukur, por për fat të keq në dyqanin e babait tim shiten vetëm veshje për burra. Mamaja ime quhet Janki. Ajo kujdeset për shtëpinë tonë dhe për ne fëmijët. Vëllai im i madh Aryan është dymbëdhjetë vjeç. Ne kemi një familje shumë të madhe. Në foto ju mund të shihni disa nga hallat dhe xhaxhallarët e mi, kushërinj dhe kushërinj të dytë. Por kjo është vetëm familja e babait tim. Përfytyroni njëherë një foto me të gjithë të afërmit përpara!



Mirësevini në shtëpinë tonë. Ashtu si shumë njerëz në Indi, ne jetojmë në një shtëpi njëkatëshe. Ne të katërt ndajmë së bashku një dhomë gjumi, kemi një korridor, një guzhinë të vogël dhe një tualet.



Ushqimi im i preferuar:
makaronat italiane dhe
makaronat e çastit – sa të



shijshme!

Kjo jam unë përpara portës së shkollës sime. Shumica e lëndëve aty, jepen në gjuhën angleze, por në shtëpi ne flasim Hindi. Hindi është gjuha kombëtare në Indi.

Këtu po ju tregoj disa vizatime, të cilat i kam bërë në shkollë ose në shtëpi. Mua më pëlqen të vizatoj dhe të pikturoj.

Kur babai im e ka pushim, atëherë ndonjëherë shkojmë bashkë në një qendër tregëtare për të bërë pazar. Më së shumti gëzoj kur mund të bëjë pastaj gara me makina në zonën e lojrave.

Këtu më shihni përpara kishës me vëllain, prindërit dhe gjyshërit e mi. Ne në Raipur nuk kemi një ndërtesë kisha, por që prej 35 vjetësh i mbajmë shërbesat fetare në një dhomë të marrë me qera. Në shkollën e së dielës ne jemi tetë nxënës, të cilët mbikëqyren nga pesë mësues; njëra prej mësueseve është mamaja ime. Shkolla e së dielës zhvillohet të dielën në mëngjes dhe pas kësaj festojmë të gjithë së bashku shërbesën fetare.





Foto: © ZoneCreative - Fotolia.com

Përrulësia – një karakteristikë e të përrgjedhurve

Në marrëdhënien ndaj tjetrit pasqyrohet marrëdhënia me Perëndinë. Kjo vlen jo vetëm për dashurinë, por edhe për përrulësinë. Trajtime nga apostuli kryesor Jean-Luc Schneider në lidhje me një virtut themelor të krishterë.

Përrulësia është e një rëndësie të madhe në doktrinën e krishterë. Jezusi e bëri përruljen para Perëndisë, si një kusht të domosdoshëm për marrjen e shpëtimit (Mateu 18,3.4). Shkrimet e Testamentit të Ri e përshkruajnë përruljen ndaj të tjerëve, si një tipar dallues të të përrgjedhurve (Kolozianëve 3,12; Filipianëve 2,3–8). Kështu nisur nga kjo, më duket e dobishme ta shohim këtë koncept pak më nga afër dhe të pyesim veten, se çfarë kuptimi ka kjo sot për ne.

Përrulësia para më të Lartit

Aspekti „Përrulësia para Perëndisë“ është me siguri më i thjeshti për t'u kuptuar. Të jesh i përrulur përpara Perëndisë do të thotë,

- të dallosh se e kemi krejtësisht të domosdoshme mëshirën.
- të dëshmosh ndrojtje ndaj Perëndisë – Perëndia është i përsosur dhe i pagabueshëm, ne as nuk mund ta kuptojmë atë tërësisht dhe as nuk mund ta detyrojmë për asgjë.
- t'i përkushtohesh plotësisht dashurisë së tij.

Të jesh i përrulur përpara Perëndisë nuk do të thotë se e vlerësojmë pak veten. Urdhëresa: „Duaje tjetrin si veten“, tregon qartë se Perëndia nuk na ndalon ta vlerësojmë veten – pra ta duam – ose të kujdesemi për veten. Le të kemi kujdes nga thjeshtësia e gabuar, e cila kërkon të besojmë se jemi të paaftë për të bërë atë çfarë Perëndia pret prej nesh. Njeriu me të vërtetë i përrulur e merr me mend se Perëndia e njeh atë më mirë se sa ai veten e tij: Me ndihmën e Perëndisë ai do të mund të bëjë atë, çfarë pritet prej tij.

Përrulësia ndaj fqinjit tonë

Përrulësia ndaj të afërmit është një fryt i Shpirtit të Shenjtë. Ky na mëson se

- Perëndia nuk e do njeriun për atë çfarë ai është, porse e do sepse është vetë dashuri. Ai e do fqinjin tonë njësoj si ne, madje edhe atëherë kur ky është krejtësisht ndryshe nga ne. Kështu, tjetri nuk duhet të bëhet me patjetër si unë në mënyrë që të duhet njësoj.
- pavarësisht meritave tona të gjithë kemi nevojë për mëshirën e Perëndisë.

Në letrën e tij drejtuar Filipianëve, apostul Pali thotë: „... me përlësi, secili ta çmojë tjetrin më shumë se sa veten“ (Filipianëve 2,3). Parë me shikim të parë, kjo fjalë duket paksa joreale: do të kërkonte prej nesh që në përgjithësi ta vlerësonim veten më pak se të tjerët, sido që të jetë ai. Por ky interpretim nuk është i saktë. Një dëshmi për këtë është, që Pali nuk e shikonte veten kështu dhe as nuk nguronte të sqaronte se në asnjë mënyrë nuk ishte inferior ndaj të tjerëve (2 Korintasve 11,5).

Ne gjejmë një sqarim të parë të fjalës biblike në rreshtin pasues: „...secili të mos shikojë vetëm interesin e vet, por edhe atë që i shërben tjetrit“ (Filipianëve 2,4). Fjala „edhe“ është e rëndësishme. Asgjë nuk na ndalon të marrim vendime sipas interesit tonë, me kusht që këto të përfillin edhe interesat e të tjerëve.

Shembulli i Jezu Krishtit

Por Pali vazhdon edhe më tej. Për të përlësia jonë duhet të ndjekë pas shembullin e Jezu Krishtit: „ Edhe pse ishte Perëndi nga natyra, ai nuk u kap pas privilegjeve hyjnore, por hoqi dorë nga ato vullnetarisht dhe u bë si një skllav. U bë njeri në këtë botë dhe mori pjesë në jetën e njerëzve. Nga dëgjesa ndaj Perëndisë, u poshtërua aq shumë, sa që iu nënshtrua edhe vdekjes, madje vdekjes së një kriminel në kryq“ (Filipianëve 2,6–8).

Jezusi ishte i vetëdijshëm për pozitën dhe forcën e tij hyjnore. E megjithatë u vu tërësisht nën vullnetin e Atit të tij. Ai e përluli veten në nivelin e mëkatarëve, u shërbeu atyre dhe vuajti, me qëllim që t'i lartësonte ata së fundmi bashkë me veten.

Të kemi brënda vetes të njëjtin këndvështrim si Jezusi, do të thotë që të jemi njësoj po si Zoti të vetëdijshëm për përzgjedhjen tonë. Ne shohim se jemi njësoj si fqinji ynë – jemi si ky një mëkatar, i cili ka nevojë për mëshirë që të shpëtohet. Dhe ne dimë se jemi dërguar, për t'i shërbyer atij dhe për të udhëhequr drejt së mirës, dhe për ta përkrahur në rrugën e shpëtimit.

Përlulja si shërbëtorë të Perëndisë

I vetëdijshëm për shenjtërinë e detyrës së tij, një shërbëtor i Perëndisë është i përlulur. Ai e di se do të ketë gjithmonë nevojë për mëshirë e Perëndisë. Edhe pse e ushtrojmë këtë detyrë për dekada të tëra, ne nuk mësohemi me këtë.

Një shërbëtor i përlulur i përmbush udhëzimet e Zotit të tij ashtu siç ai ia kërkon. Asnjë situatë nuk mund të justifikojë që ne të mos e zbatojmë vullnetin e Jezu Krishtit!

Ai, pëveç kësaj mund ta vlerësojë drejt detyrën e tij. Zoti i dërgoi apostujt për të mësuar atë çfarë ai iu kishte dhënë – kështu që autoriteti i detyrës shtrihet vetëm mbi shpalljen e Ungjillit. Njohuritë dhe përvojat tona mund të jenë në fakt në disa raste të dobishme, por ne nuk mund të mbështetemi në autoritetin tonë të detyrës për t'ju mësuar të tjerëve përjetimet personale të besimit.

Eshtë detyra e jonë të mendojmë për të ardhmen, të krijojmë projekte dhe t'i zbatojmë ato. Por ne nuk mund ta nxisim ose madje ta detyrojmë Perëndinë për asgjë. Eshtë ai, që vendos në lidhje me rezultatin e përpjekjeve tona. Për këtë Pali ishte krejtësisht i vetëdijshëm kur iu shkroi Efesianëve: „Në dashtë Perëndia, kështu do të kthehem përsëri tek ju“ (Veprat e Apostujve 18,21). Perëndia nuk lejoi që të gjitha qëllimet e Palit të ishin të suksesshme (Romakëve 1,13). E pse duhet ta bëjë tek ne?

Përlësia ndaj bashkësisë

Sipas shembullit të Jezusit apostujt janë shërbëtorë të të gjithëve (Gjoni 13,15). Ata nuk janë zotër mbi besimin e bashkësisë, por ndihmës të gëzimit (2 Korintasve 1,24) (KNK 7.6.3). Të gjithë mbajtësit e posteve e shohin veten si shërbëtorë. Por a janë me të vertetë të tillë? Për fat të keq aty-këtu kam konstatuar, se vëllezërit

- ende e ngatërrojnë „autoritetin e detyrës, postit“ me „hierarkinë në punë“ – ata e keqpërdorin pozitën e tyre me qëllim që ta inponojnë këshillën e tyre, deri në vetëkuptueshmëri aq sa shpëtimi i motrave e vëllezërve të jetë i varur prej bindjes dhe udhëzimeve të dhëna.
- lëndohen dhe zemërohen shpejt – mos vallë i japin vetes shumë rëndësi?

Unë sa për pjesën time përpiqem të jem i hapur ndaj sygjerimeve dhe të rejave. Por nuk kuptoj, se si disa veprojnë pa kërkuar më parë këshilla apo miratime prej eprorëve të tyre. Jam shumë i bindur se një risi, që ka për qëllim përçarje, nuk ka si të shkojë në drejtimin e duhur. Po ashtu jam i bindur se Perëndia gjithnjë do ta rregullojë në atë mënyrë, që një mendim i lindur prej Shpirtit të shenjtë, medoemos do të zbatohet.



Foto: © NAK DR Kongo

Nango – më bashkësi e vogël në juglindje të Kongo, më 70 ditë pas themelimit të saj një ndërtim në parë kisha.

I Përrulësia e kishës

Të jesh i ndërgjegjshëm për pozicionin tënd – kjo është përrulja. Kjo nuk vlen vetëm për njeriun në veçanti, por edhe për të gjithë kishën. Mendime rreth kësaj nga apostuli kryesor Jean-Luc Schneider.

Njëherë më kanë pyetur se çfarë ndodh me postin e apostujve dhe sakramentet në Mbretërinë njëmijëvjeçare të Paqes? Do të doja t'ju sillja më pranë disa reflektime personale mbi këtë temë, pa i ngritur ato në një të vërtetë të paprekshme.

E ardhmja e apostulatis

Si bashkësi e të përzgjedhurve, kisha e Krishtit do të vazhdojë së ekzistuari edhe në Krijimin e ri (Katekizmi i kishës Apostolike të Re, KNK 6.4.5). Për sa i përket apostulatis

që punon brenda përbrënda kishës si dhe sakramenteve që dhurohen aty, është e rëndësishme t'i kthehemi njëherë fillimeve të kishës. Jezusi i vendosi apostujt me qëllim që ata, pas kthimit të tij tek Ati, të ishin ambasadorët, lajmëtarët e tij. Ai e ndërtoi kishën me qëllim që njerëzit të merrnin mësimet e apostujve dhe sakramentet e domosdoshme për marrjen e shpëtimit. Artikulli ynë i katërt i besimit sqaron se apostujt janë dërguar nga Jezusi „deri në rikthimin e tij“.

Në Mbretërinë njëmijëvjeçare të Paqes Jezusi do të jetë vetë

i pranishëm në tokë; ambasadorët e tij nuk do të jenë më atëherë të nevojshëm për ta përfaqësuar atë. Detyra e të përzgjedhurve, e priftërisë mbretërore do të jetë për të qenë lajmëtarë dhe dëshmitarë të Jezu Krishtit, ashtu siç ishin dishepujt, kur Jezusi ishte në tokë.

E ardhmja e sakramenteve

Sakramentet e dhuruara në kishë janë „shenja“. Ato lidhin një element të dukshëm me një fjalë, e cila tregon rreth realitetit që fshihet pas kësaj fjale (KNK 8). Ky realitet nuk është gjë tjetër veçse prania e Shpëtimtarit.

Me qenë se Jezu Krishti do të jetë përsëri i dukshëm në Mbretërinë e Paqes, atëherë sakramenti nuk do të jetë më i domosdoshëm. Jezusi e vë menjëherë në zbatim forcën e tij shpëtuese, ashtu siç veproi përsëmbull në tokë tek hajduti në kryq.

Personalisht jam i mendimit se do të më mungonte respekti ndaj Jezu Krishtit, Shpëtimtarit tonë, nëse me këmbëngulje do të pretendoja se në Mbretërinë njëmijëvjeçare të Paqes do të ishin ende të domosdoshme për marrjen e shpëtimit apostujt dhe sakramentet.

Kisha Apostolike e Re

E udhëhequr prej apostujve të gjallë edhe kisha Apostolike e Re duhet te jetë e përlulur:

- As kisha Apostolike e Re dhe as apostujt që e udhëheqin atë, nuk e kanë kompetencën për të zëvendësuar drejtimin e tanishëm dhe për të zgjidhur problemet e kësaj bote.
- Gjithashtu as nuk jemi në gjëndje për të dhënë këshilla për të gjitha çështjet.
- Ne jemi shumë të vetëdijshëm që nuk jemi njerëz perfekt dhe nuk pretendojmë në asnjë mënyrë që parardhësit tanë kanë qenë të pagabueshëm. Kisha kërkon falje për gabimet që janë bërë. Por ne nuk mundemi ta ndryshojmë dot të kaluarën. Gjithshka që mund të bëjmë është të sigurohemi, që gabimet e bëra të mos përsëriten më, duke e ditur shumë mire se pashmangshmërisht bëjmë të tjera ...

- Fakti që jemi të bindur ndaj doktrinës sonë të besimit, nuk na pengon për të njohur as pasurinë shpirtërore të kishave të tjera dhe as meritat e anëtarëve të tyre.

Dhe si përfundim, dëshiroj të ndaj me ju një citat, që më ka pëlqyer shumë. Dorotheus nga Gaza, një murg, i cili ka jetuar në shekullin e 6-të në Palestinë, ka shkruar: „Shpirtrat janë të ngjashëm me pemët frutore. Kur këto pemë mbajnë shumë fryte, degët e tyre përkulen në tokë nga pesha; e kundërta ndodh me degët që nuk mbajnë fryte, ato drejtohen për lart. Ka edhe pemë, në degët e të cilave lidhen gurë për t'i detyruar ato që të përkulen, në mënyrë që të japin fryt. Po e njëjta gjë është edhe me shpirtrat: Kur përlulen ato mbartin me vete shumë fryt dhe sa më shumë mbartin aq më të përlulura bëhen.“ (Dorothee de Gaza, Instructions I–XVII, Sources Chrétiennes, 1963; përkthyer nga frëngjishtja).

„Të gjithë me njëri-tjetrin kapuni fort pas përluljes; sepse Perëndia i kundërshton mëndjemëdhenjtë, por u jep hir të përlulurve. Përluluni pra, nën dorën e pushtetshme të Perëndisë, që ai t'ju lartësojë në kohën e duhur.“ (1 Pjetri 5,5.6)

Masthead

Publisher: Jean-Luc Schneider, Überlandstrasse 243, 8051 Zürich/Svizzera
Verlag Friedrich Bischoff GmbH, Frankfurter Str. 233, 63263 Neu-Isenburg/Germany
Editor: Peter Johanning



Foto: Arshiva qëndrore e NAK-së, Vestfalia e Rinit Verior dhe Arshiva e shtetit /bundesarchiv.de/Fotograf o. Angabe (Ushtarët në Illogore)

100 vjet Hostie: Kur kupa nuk u përdor më

Tre pikat kanë jubilenë: Të Premten e mirë 1917, apostuli kryesor festoi zyrtarisht shërbesën e tij të parë fetare vetëm me hostie pa kupën e verës. Ajo që sot është krejtësisht normale, para 100 viteve ka qenë një domosdoshmëri. – Përse?

„Tani ne sot kemi një ndryshim në shijimin e Darkës së Shenjtë.“ – Me këto fjalë apostuli kryesor Hermann Niehaus hapi një epokë të re më 6 prill 1917, në Bielefeld (Gjermani). Deri në atë kohë ishte e zakonshme të merrje bukën në formën e një shtrese të hollë brumi dhe verën nga një kupë. Tani vera përfaqësohet në formën e tre pikave mbi hostie.

Dy problemet ...

Në mes të Luftës së Parë Botërore nuk e gjeje verën kollaj. „Për të shpëtuar e kemi përdorur deri edhe gjysëm me ujë, por edhe me këtë nuk ia dilnim“, tha apostuli kryesor në shërbesën fetare historike.

Kolera, tifoja, tuberkulozi – frika nga epidemitë e bëri higjienën temë kryesore. „Kupa fshihej pas çdo pirje me një

copë dhe rrotullohet nga ai që shërbente.“ Megjithatë „u vu re se kupa rrotullohej edhe vetë nga ata që pinin“ dhe „disa prej tyre vetëm sa e thithnin, pa e prekur të njëjtën me buzët e tyre.“

... dhe tri zgjidhjet

Tri zgjidhjet i diskutoi kryeartikulli i përgatitur në gazetën e NAK-së i datës 25 mars 1917.

Nga njëra anë: Kupa të veçanta të vogla, ashtu siç përdoreshin edhe në kishat evangjeliste të vendit. Megjithatë: Me anë të kupave pak a shumë madhështore hyn në mes edhe dallime klasore, gjatë ndarjes së Bukës së Shenjtë „gjë që patjetër duhej të evitohej nga pikëpamja fetare.“

Nga ana tjetër: Zhytja në verë e Hostie mbi një pirun fildishi

dhe dhënia e saj motrave e vëllezërve, si në bashkësitë e Hollandës. Megjithatë: „Hostiet zbuteshin shumë shpejt pas kësaj.“ Ato ngjiteshin në dorë – pra gjithashtu jo fort higjienike.

Mbeti vetëm një zgjidhje: „Lufta na mësoi shumë gjëra.“

Gjëndja e vështirë si një mësues

Tetor 1915, në frontin e luftës në Francë: Ushtari me inicialet W.G. ka marrë një letër „nga apostuli i dashur kryesor, krahas Darkës së Shenjtë.“ – „Ne lutemi dhe përgjrohemi jo vetëm për ju, por po ju japim edhe atë mbi të cilën janë vendosur edhe veprat e Jezusit“, thuhet në këtë shkrim. – „Unë gëzoj këtu mbi dyshekun tim të kashtës, po si një fëmijë i vogël“, formuloi W.G. në përgjigjen e tij, e cila doli në gazetën e NAK-së, në janar të 1916.

Si fillim krahas bukëve të sheshta u vendosën edhe shishe të vogla me verë. Por këto zhdukeshin prej paketave të hapura fshehtas – po njësoj siç veprohej edhe me cigaret. Shumë shpejt pas fillimit të luftës më 1914, drejtuesit e kishës i furnizonin për këtë arsye ushtarët, vetëm me një kombinim të hostieve: „Ne shenjtërojmë (kupën e verës) dhe hostiet dhe pastaj hostiet spërkaten nga kjo kupë e shenjtëruar.“


Nuk bëhet fjalë për sasinë

A mund të barazohet kjo me Darkën e Shenjtë siç e ka dhënë Jezu Krishti? Përgjigjja e apostulit kryesor Niehaus është një krahasim i bërë me pagëzimin me ujë: „Ekzistojnë komunitete, të cilat zhyten krejtësisht nën ujë, ne mjaftohemi vetëm me spërkatje.“ Këtu ai, në shërbesën fetare të së Premtes së mirë, iu referua shumë qartë fjalëve të katekizmit të Martin Luterit: „Uji në të vërtetë nuk bën asgjë, porse fjala e Perëndisë, e cila është në ujin dhe me ujin.“

„Kur mijëra janë të kënaqur me spërkatjen, atëherë jemi edhe ne“, theksoi drejtuesi i kishës në këtë shërbesë fetare të së Premtes së mirë: „Buka do të njomet me tri pika verë të kuqe në mënyrë që të dallohet.“ Kjo në fillim vlejti vetëm për ata që bënin pjesë në zonën e punës së tij si apostul. E detyrueshme për të gjithë u bë vetëm pas një vendimi të përbashkët të marrë në vjeshtën e vitit 1919, i cili u bë i njohur nëpërmjet një shkrimi qarkor: „Nëpërmjet vendimit të apostujve kjo u bë rregull në të gjithë punën e Zotit.“

poshtë majtas: Letra me hostie dhe shishe vere
poshtë djathtas: Ushtarët e Luftës së Parë Botërore të shtrirë
në llogore gjatë një armë pushimi





Pasqyra

- 02.07.2017 Homabay/Kenia
- 14.07.2017 Lubumbashi/RD Kongos
- 16.07.2017 Lubumbashi/RD Kongos
- 23.07.2017 Barcelona/Spanjë
- 30.07.2017 Zepernick/Gjermani
- 05.08.2017 Natal/Brasil
- 06.08.2017 Natal/Brasil
- 19.08.2017 Luena/Angola
- 20.08.2017 Saurimo/Angola
- 17.09.2017 Dénia/Spanjë
- 24.09.2017 Melbourne/Australi
- 25.09.2017 Melbourne/Australi
- 28.09.2017 Wewak/Australi

New Apostolic Church
International

